



UK Health
Security
Agency

NHS

CARE



Udhëzuesi për fushatën e pranverës lidhur me vaksinimin kundër COVID-19

Këtë pranverë, vaksina kundër koronavirusit (COVID-19) do t'u ofrohet personave të moshës 75 vjeç e lart, banorëve në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit, dhe atyre 6 muajsh e lart me një sistem imunitar shumë të dobët.

Kujt i ofrohet një vaksinë këtë pranverë?

COVID-19 është më serioz te njerëzit e moshuar dhe te njerëzit që kanë probleme shëndetësore shoqëruese të caktuara. Prandaj, personave të moshës 75 vjeç e lart, atyre në shtëpitë e kujdesit për të moshuar dhe atyre 6 muajsh e lart me një sistem imunitar të dobët u ofrohet një dozë pranvere e vaksinës COVID-19.

Koha e vaksinimit të pranverës

Juve duhet t'ju ofrohet një takim midis prillit dhe qershorit, dhe ata që janë në rrezik më të lartë do të thirren të parët. Ju do të ftoheni të merrni dozën përforcuese rreth 6 muaj pas dozës së fundit, por mund ta merrni atë edhe pas 3 muajsh.

Nëse mbushni 75 vjeç ndërmjet prillit dhe qershorit, nuk keni pse të prisni deri në ditëlindjen tuaj, mund të shkoni kur të thirreni për vaksinim.

Cila vaksinë do t'ju ofrohet?

Do t'ju jepet një dozë përforcuese e një vaksine të bërë nga Pfizer ose Moderna dhe e miratuar në Mbretërinë e Bashkuar. Këto vaksina janë përditësuar që nga vaksinat origjinale dhe ato luftojnë një variant tjetër të COVID-19. Këto vaksina të përditësuara rritin mirë mbrojtjen dhe japin nivele pak më të larta të antitropave kundër varianteve më të fundit të COVID-19 (Omicron).

Ngaqë nuk mund të parashikojmë se cilat variante të COVID-19 do të qarkullojnë këtë pranverë dhe verë, Komiteti i Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin (Joint Committee on Vaccination and Immunisation, JCVI) ka arritur në përfundimin se duhet të përdoret vaksina e përdorur në javët e mëvonshme të programit të vjeshtës 2024.

Ju lutemi pranoni vaksinimin që ju ofrohet sapo të keni mundësi – do t'ju ofrohet vaksina e duhur, në kohën e duhur.



Kush nuk mund të pranojë ofertën e një vaksine pranverore

Ka shumë pak persona të kualifikuar që nuk duhet të marrin një dozë këtë pranverë. Nëse keni pasur një reagim të rëndë ndaj një doze të mëparshme vaksine, duhet ta diskutoni këtë me mjekun tuaj.

Efektet anësore

Efektet anësore të zakonshme: Ashtu si me dozën tuaj të mëparshme, efektet anësore të zakonshme janë të njëjta për të gjitha vaksinat kundër COVID-19, duke përfshirë vaksinat e kombinuara që do të përdoren këtë vjeshtë, dhe ato përfshijnë:

- një ndjenjë të dhimbshme, të rëndë dhe butësi në krahun ku keni bërë injeksionin - kjo ka tendencë të jetë më e përkeqësuar rreth 1 deri në 2 ditë pas vaksinës
- ndjenjë lodhjeje
- dhimbje koke
- dhimbje të përgjithshme ose simptoma të lehta të ngjashme me gripin

Ju mund të pushoni dhe të merrni paracetamol (ndiqni këshillën e dozës në paketim) për t'ju ndihmuar të ndiheni më mirë.

Efektet anësore pas vaksinimit zakonisht zgjasin më pak se një javë. Nëse simptomat tuaja duket se përkeqësohen ose nëse jeni të shqetësuar, mund të telefononi NHS në numrin 111, ose për telefon me tekst përdorni 18001 111.

Ju gjithashtu mund t'i raportoni efektet anësore të dyshuara të vaksinave dhe mjekimeve. Shihni informacionin e kontaktit për skemën mbrapa kësaj fletushke.


Efekte anësore të rënda: Rastet e inflamacionit të zemrës (të quajtura miokardit ose perikardit) janë raportuar shumë rrallë pasi janë bërë të dyja vaksinat Pfizer dhe Moderna kundër COVID-19. Këto raste janë parë kryesisht te meshkujt e rinj brenda disa ditësh pas vaksinimit. Shumica e personave të prekur janë ndjerë më mirë dhe e kanë marrë veten shpejt pas pushimit dhe trajtimeve të thjeshta. Duhet të kërkonit urgjentisht këshilla mjekësore, nëse pas vaksinimit përjetoni:

- dhimbje gjoksi
- gulçim
- ndjenjën e rrahjeve të shpejta të zemrës, fërgëllimeve ose rrahjeve të zemrës në mënyrë të përsëritur.

Nëse keni pasur efekte anësore të rënda pas ndonjë doze të mëparshme, mund t'ju këshillohet të shmangni ose të shtyni vaksinimin tjetër. Ju duhet ta diskutoni këtë me mjekun ose specialistin tuaj. Ju lutemi shikoni faqen e pasme të fletëpalosjes se si t'i raportoni efektet anësore.

Çfarë duhet të bëni nëse nuk jeni mirë në ditën e takimit?

Nëse nuk jeni mirë, prisni derisa të jeni shëruar për të bërë vaksinën tuaj. Ju nuk duhet të shkoni në takim nëse keni temperaturë ose mendoni se mund të jeni infektues për të tjerët.



A mund të infektoheni akoma me COVID-19 pasi keni bërë vaksinën?

Vaksina kundër COVID-19 do të ulë mundësinë që ju të sëmureni rëndë nga COVID-19 këtë pranverë dhe verë. Mund të duhen disa ditë që trupi juaj të krijojë një mbrojtje shtesë nga doza. Si të gjitha ilaçet, asnjë vaksinë nuk është plotësisht efektive. Disa persona mund të marrin ende COVID-19 pavarësisht se kanë patur një vaksinë, por çdo infeksion duhet të jetë më pak i rëndë.

Nëse nuk i keni bërë të gjitha vaksinat.

Nëse kualifikoheni por nuk jeni vaksinuar më parë ose nuk keni bërë një dozë të mëparshme, duhet ta bëni gjithsesi një dozë këtë pranverë. Shumica e personave nuk kanë nevojë për doza shtesë për të kompensuar ato që nuk kanë bërë. Nëse keni një sistem imunitar shumë të dobët, mjeku juaj mund të këshillojë një dozë shtesë tre muaj pasi të keni bërë vaksinën e pranverës.

A do të më duhet të pres pas vaksinës sime?

Nëse keni një histori alergjike, ose nëse keni pasur një reagim menjëherë pas një doze të mëparshme, mund t'ju këshillohet të qëndroni për 15 minuta pas vaksinimit.

Ju lutemi sigurohuni që t'i tregoni vaksinuesit.

Informacione të mëtejshme

Për më shumë informacion, mund të lexoni udhëzuesit për COVID-19 më poshtë.

Vizitoni **vaksinimi kundër koronavirusit** në NHS.UK.

Një fletëpalosje informacioni se **çfarë të prisni pas vaksinimit** është në dispozicion për t'u shkarkuar ose për t'u porositur.

Lexoni rreth vaksinave Pfizer për **të rriturit dhe të rinjtë e moshës 12 vjeç e sipër** për **fëmijët e moshës 5 deri në 11 vjeç** dhe **fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç** dhe vaksinën Moderna **për të rriturit** për më shumë hollësi rreth vaksinës suaj, duke përfshirë efektet anësore të mundshme.

Ju do të ftoheni për përforcuesin tuaj, mjeku juaj i përgjithshëm mund t'ju ofrojë vaksinën ose mund të rezervoni duke përdorur atë **NHS app**.



Ose mund ta vizitoni **www.nhs.uk/vaccine-walk-in** për të gjetur vendin tuaj më të afërt në vendin e vaksinimit.



Ju gjithashtu mund t'i raportoni efektet anësore të dyshuara në faqen e internetit të Yellow Card, ose duke telefonuar numrin 0800 731 6789 (09.00 deri në 17.00, nga e hëna në të premte), ose duke shkarkuar aplikacionin Yellow Card.

www.mhra.gov.uk/yellowcard



© Crown copyright 2025. 1p 750k MAR 2025 (APS). Product code: C25SP2AL Albanian. UK Health Security Agency gateway number 20241091. The leaflet can be ordered using the above product code, or downloaded from: **www.healthpublications.gov.uk**, by calling: 0300 123 1002 (lines are open 8am to 6pm Monday to Friday).

There are also translated versions of this leaflet in Albanian, Arabic, Bengali, Bulgarian, Chinese (simplified), Chinese (traditional, Cantonese), Estonian, Farsi, French, Greek, Gujarati, Hindi, Italian, Latvian, Lithuanian, Pashto, Polish, Portuguese, Punjabi, Romanian, Romany, Russian, Somali, Spanish, Tagalog, Tetum, Tigrinya, Turkish, Twi, Ukrainian, Urdu, Yiddish and Yoruba. You can also download an audio version and BSL video, and order a braille and large print copy.